



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3964/2024
Data: 20.05.2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e katërt -IV- për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.04.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin Natyra Kalisi (Drejtoresh e Administratës), Hisni Luri (Drejtor për Arsim), Arbenita Bajramaliu (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), Vjosa Rogaqi (Zyrtare për Barazi Gjinore).

Zaim Bela thekson: pasi që z.Mefail Suma për shkaqe shëndetësore nuk është prezentë si anëtarë më i vjetër do ta kryesojë unë mbledhjen.

RENDI I PUNËS

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore.**
- 3. Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale.**
- 4. Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**
- 5. Eventuale.**

Zaim Bela thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Zaim Bela thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Zyrтарin e Zyrës për barazi gjinore.

Zaim Bela thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vjosa Rogaqi thekson:- përfaqësues i avokatit të popullit ishte sot në komunën tonë i cili për çdo muaj ka vizita në komunën tonë për ankesa dhe probleme lidhur me qytetarë dhe sot ka mbajtur ligjërata në shkollën fillore “Ilaz Thaç” për dhunën në familje dhe diskriminimin.

Zaim Bela thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Takim me Zyrтарin e Zyrës Kadastrale.

Zaim Bela thekson:- përfaqësuesit nga zyra kadastrale nuk janë prezent dhe do t'i thërrasim përsëri në mbledhje të radhës.

4. Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Zaim Bela thekson:- kur do të mbahet festivali tradicional.

Hisni Luri thekson:- me kuvend e kemi përcaktuar që do të jenë ditët e kulturës që do të fillon nga data një qershor dhe me datë nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë qershor është festivali.

Ajnure Thaçi thekson:- a do të ju paguhet udhëtimi mësimdhënësve.

Hisni Luri thekson:- ne jemi dokorduar se nëse hyjmë në marrëveshje duhet me sakrifikuar diçka dhe për pjesën e udhëtimit kemi menduar mos me hyrë në kalkulime për shkak se nuk janë shuma shumë të mëdha për mësimdhënësin. Marrëveshje kemi bërë dhe po shpresojmë që me ju përmbajtur kësaj marrëveshje.

Resul Suma thekson:- a do të kryhen në këtë vit. Kam dëgjuar që edhe zyrtarët kanë kontrata kolektive.

Hisni Luri thekson:- po besoj që kryhen sepse marrëveshja e kontratës kolektive është deri në vitin 2022.

Ajnure Thaçi thekson:- është dashur me u paguar për çdo vit në mënyrë që mos me i lënë këto obligime deri tash.

Hanumshahe Dibrani thekson:- për çështjen e shujtave për fëmijë a ka diçka konkrete.

Hisni Luri thekson:- kontratën e kemi pasur dhe ne prej komunave të para kemi filluar me implementuar projektin që Ministria e ka nisur dhe i kemi shpenzuar ato mjete . Ministria përmes telefonit më ka kërkuar informata se a janë shfrytëzuar mjetet dhe presim që shtatorin kur ta fillojmë me filluar edhe me shujtat për fëmijë.

Resul Suma thekson:- kur ju dalin mjetet financiare klubeve sportive.

Arbenita Bajramaliu thekson:- lista e përfituesve është shpallur dhe tash janë procedurat tjera që duhet mu kryer.

Zaim Bela thekson:- a është bërë ndonjë marrëveshje me kompaninë Sharrcem për me i subvencionuar klubet sportive.

Resul Suma thekson:- kjo është përmes bordit të Sharrcemit dhe komisionit prej komunës dhe klubi do ta nënshkruan kontratën direkt me kompaninë Sharrcem.

Zaim Bela thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.


4.Eventuale

Zaim Bela thekson:- shpallja për zgjedhjen e administratorit të Hanit të Elezit dhe është mirë që me marr pjesë sa më shumë qytetarët. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyrë Kalisi thekson:- është mirë që edhe ju që jeni prezentë dhe që keni të drejtë vote ju ftojë që të merrni pjesë në përzgjedhjen e administratorit të Hanit të Elezit. Së bashku me komisionin kemi mbajtur takim dhe kemi vendosur që me datë 03.05.2024 në ora 19:00 me u mbajtur takimi për zgjedhjen e administratorit të Hanit të Elezit. Njoftimi është bërë me kohë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:37.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Anëtar i Vjetër
Zaim Bela

